

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për Planin vendor social, 2026-2028.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Besmir Veli.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Delvinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin vendor social, 2026-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Bashkinë Delvinë, sipas kalendarit më poshtë:

	Data	Ora	Vendi
Delvinë	11.08.2025	11.00	Salla e mbledhjeve në bashki

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaileve: [anilajanku@yahoo.com](mailto:anilajanku@yahoo.com)

dhe [keshilibashkiakdelvine@gmail.com](mailto:keshilibashkiakdelvine@gmail.com)

Linku i dokumentit: <https://www.bashkiadelvine.gov.al/projekt-akte-te-hapura-per-konsultim/>

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Delvinë, organizata joqeveritare, shoqëri civile dhe grupe interesi.

Forma e konsultimit: Takim publik.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon Planit vendor social për 2026-2028.
Përshkrimi i çështjes	<p>Plani Social Vendor i Bashkisë Delvinë për periudhën 2025–2028 përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi mbrojtjeje sociale gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të orientuar nga nevojat reale të komunitetit. Ky plan strategjik trevjeçar është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare, përfshirë Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030. Ai shënon përkushtimin e Bashkisë Delvinë për të ofruar shërbime më cilësore dhe akses të barabartë për çdo qytetar.</p> <p>Dokumenti është ndërtuar mbi një diagnozë të thelluar të situatës sociale dhe një proces të hapur e gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen aktive të institucioneve vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit. Bashkia Delvinë, si një nga gjashtë bashkitë pilote në nivel kombëtar që morën pjesë në hartimin e guidës së re për planet sociale vendore, me</p>

	mbështetjen e projektit të asistencës teknike të zbatuar nga GOPA, ka fituar përvojë dhe aftësi të reja për të ndërtuar politika sociale të bazuara në evidenca dhe të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të Drejtoreshes së shërbimeve sociale, në bashki: <a href="mailto:anilajanku@yahoo.com">anilajanku@yahoo.com</a> dhe keshillit bashkiak <a href="mailto:keshillibashkiakdelvine@gmail.com">keshillibashkiakdelvine@gmail.com</a> BRENDA DATËS 18.08.2025
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Delvinë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit ose personave përgjegjës në bashki të një Përmbledhjeje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhjeje;</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhjeje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mireqenies Sociale, të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li> <li>3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të cdo rekomandimi dhe opinioni.</li> <li>4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit.</li> <li>5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar.</li> <li>6. Monitorimi i zbatimit të tij.</li> </ol>
Data e publikimit	05.08.2025